

L I G J
Nr.7921, datë 19.4.1995

PËR NJË NDRYSHIM NË KODIN E PROCEDURËS PENALE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7536, DATË 17.12.1991

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Komisionit të Ligjeve,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në Kodin e Procedurës Penale, paragrafi i tretë i nenit 116 shfuqizohet, ndërsa paragrafi i katërt ndryshohet si vijon:

“Gjykatat e rretheve dhe ato ushtarake, në shkallë të parë, kundërvajtjet penale i gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar dhe dy ndihmësgjyqtarë, ndërsa krimet me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1093, datë 4.5.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha